



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2617 Prot.

Himarë, më 30.05.2022

**VENDIM**  
**NR 29 DATË 27 .05 .2022**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME QARKUN E PUGLIA, ITALI**

Mbështetur në nenet 34,40,41,45,55 të ligjit nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin 9936 datë 26.08.2008 “Për Menaxhimin e Sistemimin Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29, kreu VII nenet 39-40 të ligjit Nr 68/2017 “Për Financat e Qeverisjes Vendore, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë nr.35, datë 21.10.2020 “Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë dhe kreditorë të huaj” Ligji i datës 11 gusht 2014, n. 125, që i referohet "Disiplinës së përgjithshme mbi bashkëpunimin ndërkombëtar për zhvillim" Dekreti i Ministrisë së 22 korrikut 2015, n. 113, me “Statutin e Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim”, Vendimin e datës 18 dhjetor 2019, n. 122, Komiteti i Përbashkët për Bashkëpunimin e Zhvillim Vendimin e datës 3 qershor 2021, n. 75 Iniciativa “Resilienza marginale: il modello della circular economy per la valorizzazione delle vocazioni territoriali”

Këshilli I Bashkisë Himarë I mbledhur në mbledhjen e tij të datës 27.05.2022 mori në shqyrtim projektvendimin e paraqitur nga bashkia mbi miratimin dhe ratifikimin e marrëveshjes midis Bashkisë Himarë dhe Qarkut të Puglias, Itali, dhe pas diskutimit që u zhvillua, në përfundim: miratoi me 14 vota pro, 0 kundra, 0 abstenim dhe...

**VENDOS:**

1. Të miratohet marrëveshja e partneritetit midis Bashkisë Himarë dhe Qarkut Puglia.
  2. Të miratohet bashkëfinancimi i Bashkisë Himarë në këtë partneritet.
  3. Kryetari i Bashkisë autorizohet të bëjë transferimin e fondeve Brenda llogarive të miratuara nga Këshilli Bashkiak për qëllim bashkëfinancimin e këtij projekti.
  4. Të miratohet relacioni bashkëshoqërues i kësaj marrëveshje partneriteti.
  5. Drejtoeria e financës, planifikimit të buxhetit dhe integritet evropian, sektori I financës, autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuara nga Këshilli Bashkiak sipas strukturës buxhetore të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas legjislacionit në fuqi

**KRYETARI**

*Dhimitër Kapaj*

